

**STATUT**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"Tirana Bailiff's" Shpk**

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;
- "Shoqëri" është Shoqëria "Tirana Bailiff's" SHPK

**KREU I**  
**THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, në datën 03.10.2018, unë, Natasha Laska, e bija e Vlash-it, e datëlindjes 05.11.1978 me cilësinë e ortakut të vetëm themelues krijoj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emrin "Tirana Bailiff's" SH.P.K.

**Neni 2**

**Objekti**

Shoqëria do të ketë për objekt ekzekutimin e titujve ekzekutivë si më poshtë:

- (1) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmbajnë një detyrim, vendimet e dhëna prej tyre për sigurmin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm;
- (2) vendimet penale të formës së prerë në pjesën që bëjnë fjalë për të drejta pasurore;
- (3) vendimet e gjykatave e të arbitrazheve të shteteve të huaja që u është dhënë fuqi, sipas dispozitave përkatëse të ligjit;
- (4) vendimet e një gjykate arbitrazhi në Republikën e Shqipërisë;
- (5) aktet noteriale që përmbajnë detyrime në të holla, si dhe aktet për dhënien e kredive bankare ose aktet për dhënien e kredive nga institucionet financiare jo bankare;
- (6) kambialet, çeqet e letrat me urdhër që barazohen me ato;
- (7) aktet e tjera që sipas ligjeve të vecanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e permbarimit për ekzekutimin e tyre.

**Neni 3**

**Kohëzgjatja**

Shoqëria krijohet për një afat të papërcaktuar.

#### **Neni 4**

##### **Selia**

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: “*Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Kulla 1 Kati 5, Zyra 11*” Tiranë.

### **KREU II KAPITALI**

#### **Neni 5**

##### **Kapitali themeltar**

- (1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lekë e përbërë nga një kuotë e vetme.
- (2) Ortaku themelues Natasha Laska është zoterues i 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

#### **Neni 6**

##### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Me vendim të ortakut, kapitali i shoqërisë mund të zvogëlohet ose të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

#### **Neni 7**

##### **Transferimi i kapitalit**

Me vendim të ortakut të vetëm kuotat e kapitalit të shoqërisë mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

### **KREU III**

#### **ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8**

##### **Organet Vendimarrëse**

Organet vendimarrëse të shoqërisë janë:

- 1- Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
- 2- Administratori.

## **Neni 9**

### **Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve**

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendos për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorit;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

## **Neni 10**

### **Administrimi**

- (1) Administrator i parë i shoqërisë është ortaku i vetëm i saj znj. Natasha Laska.
- (2) Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

## **Neni 11**

### **Kompetencat e Administratorit**

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare në raport me të tretët dhe pranë organeve shtetërore;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara ortakut në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

## Neni 12

### Përgjegjësite e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga ortakut i vetëm që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakut kontributet;
- b) u paguan ortakut interesa apo dividendë;

- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortaku ka të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

## **KREU IV VITI FINANCIAR-EKSPERTËT**

### **Neni 13 Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

### **Neni 14 Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorezojë në kohë ortakut për t'i shqyrtuar e miratuar.

## **KREU V PRISHJA E SHOQËRISË**

### **Neni 15 Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) me vendim të Ortakut të vetëm;
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- c) me vendim të gjykatës;

Në këte rast Ortaku merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku.

**Neni 16**  
**Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 17**  
**Mosmarrëveshjet**

Per mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Tiranës.

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË "TIRANA BAILIFF'S" SHPK**

**NATASHA LASKA**

\_\_\_\_\_  
*Natasha Laska*  
*[Signature]*